

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Klinës 2012

Tetor 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje.....	5
2. Problemet në Komunën e Klinës	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Klinës	7
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2012	13
6. Administrata e Komunës së Klinës	15
7. Arsimi në Komunën e Klinës	17
8. Shëndetësia në Komunën e Klinës	18
9. Transparenca	20
10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	22
11. Burimet	25

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Klinës, me 38.496 banorë, hyn në mesin e komunave mesatare për nga numri i popullsisë dhe madhësia e territorit. Që nga viti 2007, Klina udhëhiqet nga PDK dhe kryetari Sokol Bashota. Z.Bashota dhe PDK fituan shumicën e votave edhe në zgjedhjet e fundit lokale të 2009, duke fituar të drejtën që të qeverisin me këtë komunë deri në fund të 2013. PDK ka arritur koalicion me LDK dhe LDD, duke e ndarë pushtetin ekzekutiv.

Gjatë këtij mandati, komuna e Klinës është karakterizuar me keqpërdorime të shumta të parasë publike, shkelje të ligjeve në fuqi, mos realizim të premtimeve zgjedhore, shkelje të procedurave të tenderimit, mos transparencë, largime të të punësuarve në baza partiake, punësime në baza familjare, etj.

Për dy vite radhazi, 2011 dhe 2012, komuna e Klinës shpenzon më shumë buxhet për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare se sa për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, shëndetësore dhe ato të banimit kolektiv. Në vitin 2011 janë shpenzuar 35.100 euro për mirëmbajtje dhe riparim të veturave. Shumë më shumë është shpenzuar për mirëmbajtje të veturave se sa për mirëmbajtje të shkollave (30.724 euro), mirëmbajtje të ndërtesave (8.586 euro), mirëmbajtje të objekteve shëndetësore (13.551 euro). Në periudhën janar-shtator 2012 janë shpenzuar 20.924 euro për mirëmbajtje të veturave, shumë më shumë se për mirëmbajtjen e objekteve shkollore (19.239 euro), objekteve shëndetësore (2.455 euro), apo mirëmbajtjen e ndërtesave (11.329 euro).

Më 2011, komuna e Klinës ka shpenzuar 87.743 euro për karburante për vetura, apo shumë më shumë se komunat e përfaqësuara si Vitia, Lipjani apo Vushtrria. Edhe të dhënat e nëntë mujorit të 2012 tregojnë se kjo komunë nuk ka qenë e kujdesshme në harxhimin e karburanteve për vetura, ku për periudhën janar-shtator 2012 janë shpenzuar 66.504 euro. Në bazë të këtij trendi, më 2012 komuna e Klinës do të shpenzojë karburante për vetura më shumë se sa më 2011.

Gjatë vitit 2011, komuna e Klinës ka shpenzuar 37.891 euro për dreka zyrtare, shumë më shumë se komuna e Prizrenit, Malishevës, Vitisë, Kamenicës, Lipjanit, Deçanit. Si dhe ka shpenzuar 27.976 euro në telefon fiks dhe mobil (më shumë se komuna e Prizrenit e cila është shumë më e madhe se komuna e Klinës për nga numri i popullsisë dhe territori).

Komuna e Klinës i ka shkelur të drejtat e punëtorëve në disa raste. Rasti më ekstrem i shkeljes së Ligjit për Shërbimin Civil dhe vendimin e gjykatave të Kosovës është rasti i largimit nga puna të shërbyesit civil Viktor Marku. Z. Marku është larguar padrejtësisht nga puna më 30 qershor 2010. Për dy vite e gjysmë ai është ankuar në të gjitha organet gjyqësore, duke filluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM), Gjykata Komunale, Gjykata e Qarkut, Gjykata Supreme, Gjykata Kushtetuese, dhe të gjitha këto

institucione kanë vendosur që Viktor Marku duhet të kthehet në punë dhe komuna e Klinës duhet ta kompensojë atë për atë kohë sa është larguar nga puna padrejtësisht. Por, të paktën deri në fund të tetorit 2012 Komuna nuk e ka respektuar asnjë vendim të organeve të gjyqësisë. Mos respektimi i vendimeve të KPM dhe gjykatave paraqet shkelje të rëndë ligjore në bazë të së cilës, Kryeministri i Kosovës do të duhej, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, të iniciojë pranë Gjykatës Kushtetuese procedurën për shkarkimin e Kryetarit të Komunës, Sokol Bashota.

Administrata e komunës së Klinës është e vendosur në njërin nga objektet më moderne në Kosovë apo siç ka filluar të njihet edhe si “Shtëpia e Bardhë e Klinës.” Mirëpo, ndërtimi i këtij objekti komunal është karakterizuar me kosto të lartë dhe shkelje të Planit Zhvillimor Urban. Si kompensim për ndërtimin e objektit komunal, punë-kryesit iu dha e drejta që në qendër të qytetit të ndërtojë dy ndërtesa të reja shtatë katëshe. Pas përfundimit të punimeve në objektin e ri komunal, udhëheqësit komunal “kujtohen” se në marrëveshje nuk e kanë përfshirë edhe ndërtimin e sallës së mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Si rrjedhojë, komuna i lejon kompanisë kontraktuese që të ndërtojë edhe nga dy kate shtesë në dy ndërtesat e banimit kolektiv. Në këtë rast janë bërë disa shkelje ligjore: së pari, zyrtarët komunal kanë bërë shkelje duke mos e precizuar në kontratë gjithë obligimet e punë-kryesit, me ç’rast nuk është përfshirë salla e Kuvendit Komunal; së dyti, kostoja e rregullimit të sallës së KK do të ishte shumë më e vogël se sa dhënia e lejes për të ndërtuar dy kate shtesë në dy ndërtesa të banimit kolektiv; dhe së treti, duke lejuar ndërtimin e objekteve nëntëkatëshe, komuna e Klinës ka shkelur Planin Zhvillimor Urban, në të cilin thuhet se në qytetin e Klinës nuk mund të ndërtohen ndërtesa mbi gjashtë katëshe, për shkak të rrezikut nga lëvizjet e dheut.

Gjatë këtyre viteve, në komunën e Klinës është investuar shumë në infrastrukturë rrugore, shkolla dhe objekte shëndetësore. Përveç investimeve nga komuna e Klinës, në këtë komunë disa projekte janë financuar edhe nga Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Përkundër asaj se nëpër territorin e komunës së Klinës kalojnë pesë lumenj dhe kjo komunë është e pasur me ujëra, banorët e kësaj komune përballen me mungesë të ujit të pijes. Së fundmi, analizat nga Instituti i Shëndetit Publik kanë konstatuar se uji i Klinës nuk bën të pihet, në rast se nuk pastrohet nga ndonjë fabrikë e ujit.

Tani kur kanë mbetur edhe një vit nga zgjedhjet e ardhshme lokale, kryetari i Komunës së Klinës ka arritur të realizoj vetëm gjysmën e premtimeve të dhëna në fushatën zgjedhore të 2009.

1. Hyrje

Pas shtatë viteve të qeverisjes së komunës së Klinës nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), zgjedhjet lokale të vitit 2007 nxorën Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) si forcën më të madhe politike në këtë komunë. Në zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për kryetar komune fitues doli Sokol Bashota nga PDK. Sokol Bashota u rizgjodh kryetar komune edhe pas zgjedhjeve lokale të 2009, kësaj radhe për një mandat katër vjeçar (2009-2013). Në balotazh për kryetar komune, Sokol Bashota fitoi ndaj kundër kandidatit Enver Berisha (AAK) me 57.1% të votave.

Koalicioni qeverisës në Klinë përbëhet nga PDK, LDK dhe LDD. Komuna e Klinës ka 10 drejtori. Asnjë nga to nuk udhëhiqet nga femrat. Kuvendi Komunal i Klinës përbëhet prej 27 anëtarësh, prej të cilëve nëntë ulëse i mbajnë përfaqësuesit e PDK, nëntë ata të AAK, gjashtë LDK, dy LDD dhe një ulëse PSHDK.

Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, del se komuna e Klinës ka 38.496 banorë, prej tyre 96.6% shqiptarë, 2.8% nga komunitetet rom, ashkali, egjiptas, 0.25% serb, 0.05% boshnjak.

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në komunë e Klinës për periudhën janar 2010 - shtator 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e Klinës, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurorimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

2. Problemet në Komunën e Klinës

Përveç papunësisë së lartë, rasteve të shumta me ndihmë sociale, banorët e komunës së Klinës përballen edhe me probleme tjera, zgjidhja e të cilave është kompetencë e strukturave komunale qeverisëse. Problemet më të mëdha me të cilat përballen banorët e këtij lokaliteti janë mungesa e ujit të pijes, mbeturinat dhe ndotja e ambientit, mungesa e ndriçimit publik në qytet, mungesa e një stacioni të autobusëve, etj.

Fshatrat e Komunës së Klinës, sidomos ato në pjesën verilindore të komunës, kanë mungesë të ujit të pijes. Edhe pse Zyra e Komisionit Evropian ka investuar në këtë drejtim duke ndërtuar impiantin në vlerë prej 400.000 euro, ky projekt ka dështuar për shkak të kapacitetit të vogël për filtrim të ujit. Menaxherët e "Hidrodrinit" qysh në fillim ia kanë bërë me dije udhëheqësve komunal se ky impiant nuk mund të jetë funksional për shkak se nuk ka kapacitet për pastrim të ujit dhe është i ndërtuar jashtë

standardeve. Tanimë ky ujë nuk përdoret për pije pasi që përmban materie të dëmshme kimike dhe biologjike.¹ Edhe qyteti i Klinës akoma nuk ka ujë të pijshëm. Projekti për vendosjen e gypave për sjelljen e ujit nga Istogu ka dështuar pasi se nuk ka pasur kurrfarë bashkëpunimi në mes të komunës së Klinës dhe asaj të Istogut. Gjashtëmbëdhjetë fshatra të Klinës furnizohen me ujë të pijes nga “Pusi i Jarinës”, ku kualiteti i këtij uji është jo i mirë.

Një problem i cili nuk është menaxhuar si duhet nga Komuna e Klinës dhe kompania rajonale për mbeturina është edhe problemi i mbeturinave nëpër fshatra dhe, në një masë më të vogël, edhe në qytet. Kompania regjionale e mbeturinave mbulon vetëm qytetin, gjersa nëpër fshatra janë krijuar deponi të shumta të mbeturinave. Ky problem ka qenë edhe njëri nga pesë problemet e Klinës në prag të zgjedhjeve lokale 2009.²

Qyteti **nuk ka ndriçim publik** dhe komuna nuk e ka parë të udhës që të ndajë buxhet komunal apo të hartojë ndonjë plan për instalimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik në qytet.

Një nga organizatat jo qeveritare lokale, OJQ “KOHA”, më 30 qershor 2011 kishte organizuar një debat publik, me ç’rast të pranishmit³ kishin ngritur këto shqetësime:

- Mungesa e librave në Bibliotekën e qytetit, por edhe ndërprerjet e rrymës;
- Prezenca e kafiterive të shumta dhe të zhurmshme në rrugën e gjimnazit, ku lëshohet muzikë me zë të lartë dhe ku rinia i frekuenton shumë këto lokale, duke bërë që të shkaktohen shumë mungesa në orët mësimore (në debat janë përmendur 32.000 mungesa të nxënësve);
- Problemi i mos pagesës së borxheve të rrymës nga vetë Komuna, çka ka bërë që KEK-u të shkyç nga rrjeti elektrik shkollat, objektin komunal, ambulancat, bibliotekën, etj. Mos shlyerja e borxheve ndaj KEK-ut është konsideruar shembull i keq ngase mund të dërgojë sinjal të gabuar tek qytetarët për mos pagesë të rrymës;
- Asnjë lagje në qytetin e Klinës nuk ka kënd të lodrave të rrethuar për fëmijë. Ata sot lozin nëpër rrugët e lagjeve të tyre duke u rrezikuar nga automjetet e shumta.⁴

¹ Programi i IPA-s i Bashkimit Evropian për Kosovën. Studimi i Fizibilitetit për Kualitetin e ujit të pijshëm në Kosovë. 1 tetor 2009. Burimi: http://www.niph-kosova.org/index.php?option=com_jdownloads&Itemid=6&view=finish&cid=39&catid=3

² Instituti GAP. Letërnjoftimi i Komunës së Klinës 2009. Burimi: http://institutigap.org/repository/docs/Klina-raporti_komunal.pdf

³ Në bazë të përmbledhjes së diskutimeve që kjo organizatë i ka dërguar Kryetarit të Komunës z.Bashota, të pranishëm në debatin publik kamë qenë nënkryetari i Klinës z.Zenun Zeqa, Kryesuesi i KK z.Fadil Gashi, përfaqësues së medias, shoqërisë civile, anëtarëve të opozitës, qytetarë.

⁴ OJQ “Koha”, debat publik me qytetarë dhe përfaqësues komunal, mbajtur më 30 qershor 2012, Klinë.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Klinës

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2011 ishte mbi 7.3 milion euro apo 3.13% më shumë se sa ishte planifikuar. Edhe të hyrat vetanake më 2011 ishin 12.38% më të larta se sa planifikimi. Mirëpo, të hyrat vetanake të 2011 në komunën e Klinës ishin më të ulëta se në 2010 për 1.4%.

Planifikimi i Buxhetit të komunës së Klinës për 2012 është mbi 6.9 milion euro apo për afro 300 mijë euro më pak se sa realizimi i një viti më parë (2011). Tabela më poshtë paraqet buxhetin komunal të Klinës për vitet 2010-2012.

Tabela nr.1: Buxheti i Komunës së Klinës 2010-2012

	2010	2011	Dallimi '10-'11	Planifikimi 2012	Dallimi '11-'12
Të hyrat vetanake	729.144,78	719.035,49	↓	780.000,00	↑
Granti qeveritar	5.328.331,00	6.441.131,40	↑	6.198.156,00	↓
Të bartura nga vitet e mëparshme	230.705,75	132.825,20	↓	-	-
Granti i donatorëve	18.369,74	54.758,89	↑	-	-
Buxheti total	6.306.551,27	7.347.750,98	↑	6.978.156,00	↓

Granti qeveritar për Komunën e Klinës përbën rreth 88% të buxhetit komunal. Granti për komunën e Klinës pritet të shënojë rritje në vitet në vazhdim, ngase sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë, komuna e Klinës ka më shumë banorë se sa që është përlllogaritur nga Ministria e Financave për ndarjen e grantit të kësaj komune. Granti i përgjithshëm (duke mos llogaritur grantin për arsimin dhe shëndetësinë) pritet të shënojë rritje prej 7%.⁵

Sa i përket të hyrave vetanake, më 2011 të dhënat tregojnë se pjesën më të madhe të të hyrave vetanake komuna e Klinës e gjeneron nga tatimi në pronë (210.055 euro apo 29.2% të të hyrave totale vetanake), nga licencat (92.382 euro apo 12.8%), nga gjobat e gjykatave (66.375 euro apo 9.2%), etj. Të hyrat nga gjeodezia dhe inspekcioni kanë shënuar rënie më 2011 në krahasim me një vit më parë.

Pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Klinës, ashtu sikurse e të gjitha komunave të Kosovës, shpenzohet për paga dhe mëditje. Në vitin 2011, 59.2% e buxhetit është

⁵ Instituti për Studime të Avancuara GAP. *Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ndikimi i tyre në politikën publike*. Prishtinë, tetor 2012. Burimi:

<http://www.institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

shpenzuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Administrata e Komunës së Klinës është e mbingarkuar me staf dhe kjo është një nga arsytet se përse mbi gjysma e buxhetit të komunës është e dedikuar për këtë kategori. Pjesa tjetër e buxhetit shpenzohet për investime kapitale (28.2%), mallra dhe shërbime (8.8%), shërbime komunale (2.59%) dhe subvencione dhe transfere (1.21%).

Bazuar në Raportin Financiar të Shpenzimeve të Komunës së Klinës për vitin 2011 del se kjo komunë ka shpenzuar shumën më të madhe të buxhetit në derivate për automjete, udhëtime brenda dhe jashtë vendit, dreka zyrtare:

- 87.743 euro karburante për vetura;
- 35.100 euro për mirëmbajtje dhe riparim të veturave. Shumë më shumë është shpenzuar për mirëmbajtje të automjeteve se sa për mirëmbajtje të shkollave (30.724 euro), mirëmbajtje të ndërtesave (8.586 euro), mirëmbajtje të objekteve shëndetësore (13.551 euro);
- 37.891 euro për dreka zyrtare;
- 27.976 euro për komunikim, prej të cilave 10.666 euro për telefon mobil dhe 17.310 për telefon fiks.
- 14.438 euro për udhëtime, prej tyre 8.876 euro për udhëtime brenda vendit dhe 5.463 euro për udhëtime jashtë vendit.
- 58.129 euro janë shpenzuar për furnizim të zyreve.

Shpenzimet e Komunës së Klinës për karburante, dreka zyrtare dhe telefon janë më të mëdha në krahasim me komunat tjera të përafërta. Për shembull, për telefoni fikse dhe mobile, Komuna e Klinës më 2011 ka shpenzuar më shumë se sa Komuna e Kamenicës, Prizrenit, Malishevës, Lipjanit, por ka më pak të shpenzuara se sa Komuna e Vushtrrisë dhe Vitisë. Kurse për dreka zyrtare, Komuna e Klinës ka të shpenzuara më shumë mjete gjatë 2011 se sa Komuna e Prizrenit, e cila është më e madhe me territor dhe numër të banorëve. Për karburante, Klina ka shpenzuar më shumë buxhet se sa Lipjani, Vitia dhe Vushtrria, kurse më pak se sa Kamenica, Prizreni, Malisheva dhe Deçani.

Tabela nr.2: Krahasimi i shpenzimeve për karburante për vetura, dreka zyrtare dhe telefonata zyrtare në mes të komunës së Klinës dhe shtatë komunave të përafërta

Shpenzimet (euro) më 2011 nga disa komuna për këto tri kategori:	Karburante për vetura	Dreka zyrtare	Telefon mobil&fix
Klina	87.743	37.891	27.976
Kamenica	110.357	24.709	21.733
Prizren	153.346	32.580	25.323
Malisheva	107.677	27.722	18.161
Vitia	78.868	29.822	30.818
Lipjani	67.299	23.864	16.014
Vushtrria	67.347	38.497	43.026
Deçani	108.451	18.211	-

Klina është një ndër komunat e pakta e cila për vitin 2012 ka buxhet më të vogël se më 2011. Buxheti Komunal për 2012 është mbi 7.2 milion euro⁶, kurse më 2011 ishte mbi 7.3 milion euro. Granti qeveritar më 2012 është më i vogël se më 2011, si dhe granti i donatorëve ka shënuar rënie. Sipas të dhënave nga nëntë mujori i parë i 2012, të hyrat vetanake të Komunës së Klinës për periudhën janar-shtator 2012 janë për 8% më të ulëta se sa në të njëjtën periudhë të një viti më parë (apo 36.937 euro më pak).⁷

Me gjithë buxhetin më të ulët për vitin 2012 dhe të hyrave më të pakta, shpenzimet buxhetore për periudhën janar-shtator 2012 nuk tregojnë se komuna ka qenë e kujdesshme në shpenzime. Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar shumë më shumë mjete buxhetore për karburante, udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit, dreka zyrtare, mirëmbajtje të veturave, telefonata zyrtare. Këto shpenzime janë regjistruar gjatë nëntë mujorit të parë 2012:

- 66.504 euro janë shpenzuar për karburante për vetura;
- 20.192 euro për dreka zyrtare;
- 96.509 euro për shpenzime të komunalisë (rrymë, ujë, mbeturina);
- 24.545 euro për telefon (fiks dhe mobil);
- 20.924 euro për mirëmbajtje të veturave. (Sa për krahasim, mirëmbajtja e objekteve shkollore për periudhën janar-shtator 2012 ka kushtuar 19.239 euro; objekteve shëndetësore 2.455 euro; mirëmbajtja e ndërtesave 11.329 euro).

Sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2013-2015, në tri vitet në vazhdim buxheti total i Komunës së Klinës nuk pritet të tejkalojë shifrën e tetë milion eurove.

Tabela nr.3: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Klinës 2013-2015

Komuna e Klinës	2013	2014	2015
Buxheti total	7.199.416,00	7.415.398,48	7.643.260,43

⁶ Shifra e plotë: 7.248.104,25 euro, kurse më 2011 buxheti ishte 7.347.750,98 euro.

⁷ Ministria e Financave. Raporti Nëntëmujor i Buxhetit 2012. Tetor, 2012.

4. Investimet kapitale 2010-2012

Gjatë tri viteve (2010-2012) komuna e Klinës ka destinuar në total 5.843.278 euro për investime kapitale.

Tabela nr.4: Investimet kapitale me buxhetin komunal të Klinës 2010-2012

Buxheti komunal për investime kapitale	2010	2011	Planifikimi 2012
	2.106.856,56	1.992.836,93	1.833.585
	Gjithsej		5.843.278

Disa nga investimet kryesore kapitale të komunës së Klinës përgjatë viteve 2010-2012 janë:

Tabela nr.5: Investimet më të rëndësishme kapitale 2010-2012

Viti	Projekti	Shuma (euro)
2010	Trotuari në Caravik	28.731
2010	Trotuari në Dush	28.800
2010	Trotuari në Radullovc	20.000
2010	Kanalizimi në lagjen "Arbëria"	45.000
2010	Kanalizimi në Sverk	60.000
2010	Ndërrimi i kulmit në Sh.F. Ujmir	25.000
2011	Kanalizimi në fshatin Zajm	40.000
2011	Ndërtimi i rrugës Avni Rustemi	20.000
2011	Kanalizimi fekale në Dobërdol	50.000
2011	Kanalizimi në rrugën "Faruk Elezi"	30.000
2012	Ndërtimi i shkollës në Siqev - faza e dytë	40.000
2012	Asfaltimi i rrugës në lagjen e Buzhalëve	10.000
2012	Ndërtimi i objektit të emergjencës - faza e dytë	45.000

Në këtë shumë të investimeve kapitale ka ndihmuar edhe qeveria qendrore dhe donatorët ndërkombëtar. Disa nga projektet kryesore për vitet 2010 dhe 2012 të investuara nga Qeveria e Kosovës janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela nr.6: Investimet kapitale në Klinë me financim të nivelit qendror

Viti	Projekti	Financuesi	Shuma (euro)
2010	Asfaltimi i rrugës në fshatin Zajm	Ministria e Infrastrukturës	67.000
2010	Ndërtimi i rrugës në fshatin Drenovc	Ministria e Infrastrukturës	189.207
2010	Ndërtimi i rrugës në fshatin Gjurgjevik	Ministria e Infrastrukturës	126.000
2010	Ndërtimi i rrugës Jashan-Shtupel-Klinë	Ministria e Infrastrukturës	276.152
2010	Asfaltimi i rrugës Klinë - Buqicë	Ministria e Infrastrukturës	680.718
2010	Asfaltimi i rrugës Klinë-Ternofc (K. Skenderajt)	Ministria e Infrastrukturës	844.000
2010	Ndërtimi i qendrës sociale në Klinë	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	123.827
2010	Rregullimi i shtratit të lumit Klina	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	878.693
2012	Rregullimi i shtratit të lumit Klina	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	150.000
2012	Palestra e sporteve	Ministria e Klaturës, Rinisë dhe Sporteve	400.000
2012	Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme në Klinë	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)	450.000
2012	Ndërtimi i shkollës fillore në Klinë të Epërme	MASHT	300.000
2012	Rehabilitimi i rrugës Klinë-Turiqec	Ministria e Infrastrukturës	500.000

Mirëpo, investimet kapitale janë përcjellë edhe me raste të keqpërdorimit të parasë publike, orientim të investimeve në ato lokalitete nga vijnë udhëheqësit komunal, angazhim të kompanive në baza partiake dhe familjare në kryerjen e punëve publike, e deri edhe tek mos mbikëqyrja e duhur e punimeve, gjë që ka rezultuar në kualitetin e dobët të punimeve.

Një nga defektet kryesore që e përcjellë këtë Komunë është dështimi i projekteve të realizuara. Edhe pse Komuna e Klinës ka investuar në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, shumica prej tyre nuk kanë ujë.⁸ Përveç ujësjellësve, projekte ende të pa finalizuara janë edhe projekti i Palestrës së Sporteve dhe ai i Shtëpisë së Kulturës.⁹

⁸ Përveç projekteve të përmendura më sipër sit ë dështuara (impianti, ujësjellësi në Glarevë, ujësjellësi në Zajm, etj.), në seancën e datës 28.9.2011 anëtar i KK z.Ndue Shabanaj (AAK) si projekt specific të dështuar përmend edhe ujësjellësin në fshatin Krushevë të Vogël.

⁹ Akuza për mos funksionim të projekteve investive janë hedhë edhe në Kuvendin Komunal të Klinës (shembull: diskutimi i përfaqësuesit të AAK të KK të Klinës z.Haxhi Ibishi, në seancën e datës 28.9.2011).

Komuna e Klinës është e vendosur në një nga objektet i cili i ngjason objektit presidencial të SHBA-së, e cila njihet edhe si “Shtëpia e Bardhë e Klinës”. Mirëpo kostoja e ndërtimit të këtij objekti në qendër të qytetit është e lartë dhe gjatë procesit Komuna ka bërë shkelje ligjore me rastin e koncesionimit të objektit komunal. Më 2009 Komuna e Klinës kishte lidhur marrëveshje koncesionimi me kompaninë “Besa Commerce” nga Lipjani për të ndërtuar objektin e ri komunal. Si kompensim, kompania ndërtuese do të merrte të drejtën të ndërtojë dy objekte në pronë komunale, në qendër të qytetit. Më 27 shtator 2009 Komuna e Klinës i jep leje ndërtimore kompanisë “Besa Commerce” për të ndërtuar dy objekte shtatë katëshe (përdhesa dhe shtatë kate, plus nënkulmi, apo B+P+7K+NK). Dhënia e lejes së ndërtimit prej shtatë katesh ishte në kundërshtim me Planin Zhvillimor Urban (PZHU). Sipas PZHU asnjë ndërtim në qytetin e Klinës nuk do mund të ndërtohet më shumë se gjashtë kate. Si arsyetim për shkeljen e PZHU, Komuna kishte marrë një raport të ekspertëve sipas të cilit thuhej se toka e Klinës e përballon ndërtimin e objekteve mbi gjashtë katëshe. Mirëpo, ky vlerësim i ekspertëve nuk është bërë asnjëherë publik, përkundër asaj se deputetët e opozitës dhe shoqëria civile kanë kërkuar të kenë qasje në këtë vlerësim.¹⁰ Për më tepër, Komuna e Klinës në fund i kishte dhënë leje “Besa Commerce”-it që t’ua shtojë edhe nga dy kate shtesë (gjithsej nëntë kate, tri kate më shumë se që lejohet me PZHU), me arsyetimin se në objektin e Komunës janë paraqitur punë shtesë – rregullimi i sallës së seancave të Kuvendit Komunal. Komuna ka mundur që financimin e rregullimit të sallës ta mbulonte me mjete vetanake, pa i dhënë leje kompanisë ndërtimore që të ndërtojë katet shtesë. Komuna asnjëherë nuk e ka bërë publik vendimin dhe arsyetimin për të lejuar ndërtimin e dy kateve shtesë nga kompania “Besa Commerce.”¹¹ Komuna është arsyetuar se mos përfshirja e sallës së mbledhjeve të KK në kontratë ka qenë lëshim i Komunës (harresë), gjersa opozita dyshon se një gjë e tillë është bërë qëllimshëm me qëllim që ndërtuesit t’i krijohen favore. Objekti i ri komunal i Klinës tri herë radhazi është vërshuar nga ujërat , gjë që ka kërkuar intervenime të posaçme në sanimin e dëmeve dhe evitimin e shkaqeve nga ku ka rrjedhur uji.

Fshati Cerrovik, prej nga ka prejardhjen Kryetari Bashota, është një nga fshatrat më të privileguara të komunës. Në këtë fshat janë shtruar rrugët, kanalizimi, ujësjellësi, trotuaret, zyra e vendit. Bashkëbiseduesit thonë se nëse në Cerrovik vendoset edhe ndriçimi publik, atëherë infrastruktura në këtë fshat mund të konsiderohet e kompletuar. Opozita në Klinë e akuzon Kryetarin për lënie anash të vendbanimeve prej nga vijnë liderët e opozitës (siç është shembulli i fshatit Qeskovë – fshati i liderit komunal të AAK). Në Kuvendin Komunal të Klinës janë hedhë akuza se investimet kapitale kanë anashkaluar edhe fshatrat Grabanicë, Gllarevë, Jagodë.¹²

¹⁰ GAP ka parë një kërkesë të OJQ lokale “Koha” e cila më 7 dhjetor 2011 ka dorëzuar Kërkesë zyrtare për të pasur qasje në vlerësimin e ekspertëve dhe nuk ka marrë përgjigje asnjëherë.

¹¹ OJQ “Koha” me kërkesën e saj drejtuar Komunës më 7 dhjetor 2011 ka kërkuar gjithashtu qasje në vendimin e Komunës për ti lejuar kompanisë ndërtimin e dy kateve shtesë.

¹² Seanca e KK të Klinës datë 28.9.2011.

Komuna ka filluar procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit Zhvillimor Urban. Deputetët e opozitës dhe shoqëria civile në Klinë mendojnë se ndryshimi i PZHU po bëhet me qëllim të përshtatjes së tij me gjendjen faktike në terren, sidomos pas ndërtimit të dy objekteve nëntëkatëshe në qendër të qytetit. Përveç kësaj, bashkëbiseduesit në këtë hulumtim shprehin brengën se PZHU po ndryshohet edhe për të legalizuar ndërtimet në zonën bujqësore të quajtur “zona e gjelbër” e cila ndodhet në mes fshatrave Dollc dhe Dresnik. Kjo zonë është kategorizuar nga vetë komuna e Klinës (2005-2006) si zonë e mbrojtur bujqësore dhe është vlerësuar si “rezervat bujqësor”. Në shkurt të 2012 ekzekutivi i komunës ka dal me propozim që në atë zonë të shtrihen ndërtimet e objekteve të ndryshme. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjëherë ndonjë masë për të mbrojtur “zonën e gjelbër” ku vetëm në tri vitet e fundit vlerësohen mbi 30 objekte të ndryshme të ndërtuara të cilat në esencë kanë ndikuar në neutralizimin dhe transformimin e asaj zone nga bujqësore në ndërtimore.

Edhe pse në këtë Komunë ndodhet një nga atraksionet më të mira natyrore që ka Kosova – Ujëvarat e Mirushës, Komuna e Klinës ende nuk ka bërë asgjë (në pjesën që i takon kësaj komune) që ky vend të jetë lehtë i qasshëm për vizitorë vendor dhe të huaj.

5. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2012

Përgjatë viteve 2010-2011, komuna e Klinës ka lidhur gjithsej 227 kontrata publike, vlera e përgjithshme e të cilave kap vlerën e mbi 7.6 milion eurove.¹³ Në vitin 2011, 13.43% e kontratave të prokurimit kanë qenë për furnizim, 6.81% për shërbime dhe 79.76% për punë.¹⁴

Tabela nr.7: Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	121	3.480.439,39
2011	106	4.129.539,52
Totali	227	7.609.978,91

¹³ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raportet Vjetore për 2010 dhe 2011.

¹⁴ Komuna e Klinës. Raport Vjetor për Punën e Ekzekutivit të Komunës së Klinës për vitin 2011. Mars 2012.

Gjatë punës së gjertanishme, procedurat e prokurimit nuk janë udhëhequr gjithnjë në mënyrë të rregullt. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka gjetur raste kur Komuna e Klinës nuk i ka respektuar procedurat e prokurimit.¹⁵

Komuna e Klinës me datë 17.03.2011 i ka dhenë të drejtën auto-larjes “Trimi 90” – në Klinë për pastrimin e veturave zyrtare në vlerë të kontratës 10.000 euro për një vit apo 17 euro për njësi (nuk specifikohet se çka është njësia në këtë rast, a bëhet fjalë për veturë apo për ditë).¹⁶ Dhënia e tenderëve në bazë të “njësisë” është konsideruar edhe nga vetë KRPP si formë jo e duhur e tenderimit, ngase lë shumë dyshime për keqpërdorime dhe e bën më të vështirë monitorimin e rregullsisë së shpenzimit të parasë publike.

Kompania private e ndërtimit e quajtur “BHK -BAO”, ka marrë të drejtën për të rregulluar stadiumin e qytetit (tribunave), ku më 2011 gjatë një ndeshje futbolli –është shembur komplet pjesa perëndimore e stadiumit duke shkaktuar lëndimin e shtatë personave dhe rrezikuar dhjetëra të tjerë. Komuna nuk e ka penalizuar këtë kompani pas këtij incidenti.¹⁷ Vlera që ka përfituar “BHK -BAO” nga rregullimi i tribunave të stadiumit është 72.959,67 euro. E njëjta firmë ka fituar edhe tenderin për rregullimin e shtratit të lumit.

Nënkryetari i Komunës së Klinës Zenun Zeça (LDD) në deklarin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion për vitin 2011 me numër të formularit 1015300 ka deklaruar marrjen e një dhurate/banesë në vlerë prej 72.000 eurove (90 metra katror) dhe po ashtu ka deklaruar marrjen e një lokali afarist në formë të dhuratës në vlerë 21.000 euro (30 metra katror).¹⁸

Në fund të vitit 2009 me një vendim të komunës janë ndarë banesa në lokalet e “Benites” me arsyetimin që udhëheqësit komunal të jetojnë në afërsi të komunës. Banese ka përfituar kryetari Bashota, Enver Berisha (AAK-së), Fadil Gashi (LDK-së), Arben Limani (LDD-së), Vezire Elshani (LDK), Esat Raci (PDK). Banesat që njihen “te Benita” janë ndërtuar me koncesion, ku rreth 27% të pronësisë e ka marrë komuna kurse pjesën tjetër investitori privat. Edhe pse banesat janë ndarë me qëllim që udhëheqësit komunal të banojnë në qytet, Kryetari Bashota banon në Prishtinë dhe

¹⁵ Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik. Vendim për aprovimin e ankesës së operatorit ekonomik “Ron-Ing” nga Deçani lidhur me aktivitetin e prokurimit publike “Punët në objektet fetare në Klinë”-LOT 1. Burimi: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/vend_meremetimi_prill10.pdf

¹⁶ KRPP. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtIID=ViewNotices&ID=41740>

¹⁷ Me Ligjin e Prokurimit Publik – Komunit (Institucionet) kanë të drejtë të sanksionojnë apo përjashtojnë kompanitë/firmat apo subjektet të cilat marrin punë nga institucioni dhe me vonë rezultojnë kryerja e atyre punëve (mos kryerja e duhur) ka mundur të shkaktoj rrezikim për jetën e njerëzve/sigurinë e tyre apo pronën.

¹⁸ Sipas formularit për deklarin të pasurisë ai këto dy dhurata i ka pranuar më 2006. Zenun Zeça është pjesë e strukturave të Komunës së Klinës që nga 2002. Formulari në AKK mund të shkarkohet nga: www.akk-ks.org/2011/Komunit_e_Kosoves/Komuna_Kline/Zenun_Zeqa.pdf

udhëton për çdo ditë për në Klinë.¹⁹ Vetë vendimi për ndarjen e banesave ka qenë i parregullt dhe paraqet konflikt interesi, ngase vetë zyrtarët të cilët kanë përfituar kanë votuar për ti ndarë këto banesa.

6. Administrata e Komunës së Klinës

Në administratën e Komunës së Klinës janë të punësuar 134 shërbyes civil. Që nga viti 2008, në administratën e kësaj komune numri i të punësuarve është sjellë nga 121 punonjës (2009) deri më 136 punonjës (2011).²⁰

Tabela nr.8: Numri i të punësuarve në administratën lokale të Klinës 2008-2012

Viti	Nr. i punësuarve
2008	126
2009	121
2011	136
2012	134

Në bazë të regjistrimit të popullsisë komuna e Klinës ka 38.496 banorë. Nëse krahasojmë numrin e të punësuarve në administratë me numrin e banorëve, i bie se mesatarisht në komunën e Klinës një shërbyes civil i shërben 287 banorëve. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 3 dhjetor 2008 për kriteret e madhësisë së administratës lokale, thuhet se në komunat nën 100.000 banorë, një shërbyes civil duhet t'u shërbej 620 banorëve.²¹ Sipas kësaj formule dhe këtij vendimi, Komuna e Klinës ka një staf të tepërt prej 79 shërbyesve civil. Komuna e Klinës me këtë numër të popullsisë, sipas vendimit të Qeverisë nr.10/46 të datës 3 dhjetor 2008, duhet të ketë më së shumti 55 shërbyes civil.²²

Administrata komunale e Klinës është e vendosur në një nga objektet më moderne dhe më të përshtatshme për punë. Andaj, për dallim nga shumë komuna tjera, shërbyesit civil në komunën e Klinës kanë kushte të favorshme të punës.

¹⁹ Nga intervista me gazetarin e KD Agron Gashi, kryetarin e AAK për Klinë Enver Berisha dhe kryetarin e Vetëvendosjes! .

²⁰ Burimi: Ministria e Administratës Publike – Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, qershor 2012.

²¹ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf

²² Për më tepër shih analizën e Institutit GAP: “Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ndikimi i tyre në politikat publike”, publikuar më 10 tetor 2012. Burimi: <http://www.institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

Mirëpo, gjatë këtyre viteve, kryetari i Komunës së Klinës ka shkelur disa herë Ligjin për Shërbyesit Civil dhe vendimet e gjykatave kompetente.

Pas decentralizimit të shërbimeve sociale më 2009 nga niveli qendror në atë lokal, ku Qendra për Punë Sociale (QPS) kaloi në menaxhim të Komunës, Komuna e Klinës filloi masat e presionit ndaj punonjësve në QPS ngase Komuna i konsideronte ata si anëtar të AAK. Kështu që më 16 dhjetor 2009 Komuna e Klinës i njofton tre punonjës të QPS se do t'u ndërpritet kontrata e punës (Enver Berishën, Ilir Bacaj dhe Viktor Marku). Pas ankesës, Komuna u'a vazhdon kontratat edhe për gjashtë muaj Ilir Bacajt dhe Viktor Markut.

Më 30 qershor 2010 Komuna ia ndërprente kontratën e punës nëpunësit social në QPS Viktor Markut dhe pesë ditë më vonë shpall konkurs për plotësimin e vendit të tij. z.Marku parashtron ankesë në Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM). Më 12 gusht 2010 KPM merr vendim²³ se Viktor Marku është larguar padrejtësisht nga puna dhe duhet të kthehet në vendin e tij të punës brenda 15 ditësh (nga muaji nëntor 2010) dhe t'i kompensohet paga të cilën do ta merrte po të ishte në punë. Komuna e Klinës nuk e respekton vendimin e KPM, edhe pse mos respektimi i vendimit të KPM paraqet shkelje të rëndë ligjore. Pasi Komuna e Klinës nuk e respekton vendimin e KPM, Viktor Marku më 18 nëntor 2010 i drejtohet Gjykatës Komunale të Klinës nga e cila kërkon ekzekutimin e vendimit të KPM. Më 14 janar 2011, Gjykata Komunale merr vendim²⁴ dhe kërkon nga Komuna e Klinës që menjëherë të kthej në vendin e tij të punës nëpunësin Viktor Marku. Komuna e Klinës nuk e respekton as vendimin e Gjykatës Komunale dhe kërkon mendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë. Edhe vendimi i Gjykatës së Qarkut është i njëjtë me atë të KPM dhe Gjykatës Komunale, por prapë se prapë Komuna nuk e respekton as vendimin e Gjykatës së Qarkut. Tani Komuna ka kërkuar mendimin e Gjykatës Supreme dhe po arsyetohet se mos kthimi i Viktor Marku në punë po bëhet për shkak se Komuna po pret mendimin e supremes. Më 10 tetor 2011 z.Marku paraqet ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese edhe një herë konstaton se komuna e Klinës i ka shkelur të drejtat nga marrëdhënie e punës dhe më 20 korrik 2012 merr vendim që z.Marku duhet të kthehet në vendin e tij të punës.²⁵ Sërish komuna e Klinës nuk respekton as vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe ky veprim i komunës e detyron Gjykatën që të reagojë në një njoftim për media publikuar më 23 tetor 2012.²⁶

Viktor Marku nga korriku i 2010 është i papunë dhe në gjendje jo të mirë sociale. Në kohën e largimit nga puna z.Marku kishte një pagë rreth 200 euro neto. Komuna duhet t'i kompensojë atij për largim të jashtëligjshëm afro 6.000 euro (në rast se z.Marku

²³ Vendimi i KPM nr.02/197/2010, i datës 12 gusht 2010.

²⁴ Vendimi i Gjykatës Komunale të Klinës nr.635/10, 14 janar 2011.

²⁵ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Aktvendimi nr.129/11. Burimi: http://www.gjks.org/repository/docs/Aktgjykim%20KI129_11_SHQ.pdf

²⁶ Gjykata Kushtetuese. Njoftim për media: <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,28,317>

kthehet në punë nga 1 nëntori 2012). Në rastin e z.Marku komuna ka shkelë vendimet e tri organeve gjyqësore.²⁷

Në të njëjtën kohë kur është larguar nga puna Viktor Marku, Komuna jashtëligjshëm ka larguar nga puna edhe inspektorin sanitar Hil Dilaj. Edhe rasti i Hil Dilajt është i njëjtë me atë të Viktor Markut. Edhe në rastin e z.Dilajt, KPM ka marrë vendim për kthimin e tij në punë. Pasi që Komuna nuk ka respektuar vendimin e KPM, Dilaj është ankuar edhe në Gjykatën Komunale të Klinës e cila e ka mbështet vendimin e KPM. Edhe Gjykata e Qarkut në Pejë ka konstatua se Dilaj është largu padrejtësisht nga puna. Paga e z.Dilaj në kohën e largimit të tij nga pune ishte afro 230 euro neto, çfarë do të thotë se edhe në rastin e z.Dilaj Komuna do të duhej të paguaj një shumë për kompensim rreth 7.000 euro. Në të dy këto raste, përveç që Komuna ka bërë shkelje të rënda të vendimeve të institucioneve gjyqësore, menaxhmenti i Komunës ka dëmtuar edhe buxhetin e Komunës me mbi 13.000 euro. Në vend të Hil Dilajt, si inspektor sanitar në punë është pranuar Dardan Bashota, kushëri i afërt i kryetarit Sokol Bashota.

Përveç rastit të Viktor Markut dhe Hil Dulaj, Komuna edhe më herët ka bërë shkelje të drejtave të punëtorëve. Pas tri viteve ankesave dhe kundër ankesave, shërbyesi civil Xhemë Manaj ka fituar rastet gjyqësore dhe komuna është detyruar që ta kthej në punë dhe ta kompensojë atë për dëmin material të shkaktuar ndaj tij pas largimit të jashtëligjshëm.²⁸ Sipas raportit të buxhetit për 2011, vetëm për vendime të gjykatave buxheti i Komunës së Klinës është dëmtuar për 25.207 euro.

Këto raste paraqesin arsye të mjaftueshme që organet kompetente (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Qeveria e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese), të fillojnë procedurat për shkarkimin e kryetarit të Komunës së Klinës, konform Ligjit për vetëqeverisje lokale.²⁹

7. Arsimi në Komunën e Klinës

Në komunën e Klinës funksionojnë gjithsej 27 shkolla fillore (objekte shkollore), dy shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në çerdhen e qytetit janë të sistemuar afro 60 fëmijë. Personel i angazhuar në çerdhe janë gjithsej 11 persona.

²⁷ Hulamtuesi i GAP ka arrit të konsultoj tërë dokumentacionin e rastit të Viktor Markut. Por këtë e argumenton edhe aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.129/11.

²⁸ Për rastin e Xhemë Manajt është diskutuar edhe në seancën e gjashtë të KK për 2011 mbajtur më 24 qershor 2011, ku anëtar i KK Haxhi Ibishi ka kuzuar Komunën se po e dëmton buxhetin komunal duke prishur kontratat e shërbyesve civil në mënyrë të jashtëligjshme.

²⁹ Neni 64 i Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Burimi:

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Tabela nr.9: Numri total i mësimdhënëseve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 27 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme në Komunën e Klinës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	545	182	363
Nxënës	9.580	4.572	5.008
Stafi ndihmës	104	4	101

Në komunën e Klinës gjatë dy viteve të kaluara është shënuar përparim në infrastrukturën e objekteve shkollore. Disa shkolla janë gëlqerosur, janë ndërruar dyert dhe dritaret.

Tabela nr.10: Disa nga investimet gjatë 2010 -2011 në infrastrukturën e shkollave të Klinës:

Investimet	Shuma (euro)
Ndërtimi i shkollës në fshatin Siqevë	337.169,37
Blerja e dyerve për shkolla	4.993
Fasadimi i objektit shkollos në fshatin Ujmirë	8.561
Rregullimi i rrethojave në shkollën e Gremnik	12.264,40
Ndërrimi i kulmit në shkollën e Zllakuqanit dhe Ujmirit	46.647,50
Rregullimi i oborrit të shkollës në fshatin Kernicë	7.500
Ndërtimi i katit të shkollës në Volljakë	75.535,00

Dy shkollat e mesme ajo "Fehmi Agani" dhe "Luigj Gurakuqi" mësimin e zhvillojnë në të njëjtin objekt. Shkolla "Fehmi Agani" është në ndërtim e sipër dhe është duke u ndërtuar me mjete të MASHT. Ky projekt është zvarritur tani e sa kohë. Përkundër premtimeve të MASHT dhe komunës, mësimi nuk ka arritur të fillojë në objektin e ri të shkollës "Fehmi Agani" as në vitin shkollos 2012/2013.

8. Shëndetësia në Komunën e Klinës

Në komunën e Klinës funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe tetë punkte shëndetësore apo ambulanca. QKMF gjendet në qendër të qytetit, ndërsa QMF janë të shpërndara, një e tillë gjendet në fshatin Zllakuqan, pastaj në fshatin Sferkë dhe në Ujëmirë. Punktet shëndetësore gjenden në Jashanicë, Jagodë, Grabanicë, Volljak, Budisalc, Cerovik, Gllarevë dhe Stubëll.

Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në komunën e Klinës është 135 të punësuar, pjesa më e madhe prej tyre në QKMF.

Tabela nr.11: Numri dhe pozitat e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë në Klinë:

Pozitat	Numri
Mjek familjar	9
Pediatër	4
Internistë	1
Stomatolog	3
Gjinekolog	1
Pneumoftiziolog	1
Biokimist	1
Infermier	65
Mami	8
Laboranta	4
Farmacisë	2
Teknik rëntgeni	2
Oftamolog	1
Infektolog	1
Staf ndihmës/administratë, pastrim, arkivim, vozitës.	32
Gjithsej	135

Në Klinë **kujdestarit e natës në Qendrat e Mjekësisë Familjare** nuk paguhen, gjë e cila krijon probleme tek stafi mjekësor, ngase ekziston një hezitim i përgjithshëm i tyre që të shërbejnë në ndërrimin e natës.³⁰ Përveç kësaj shëndetësia primare në Komunën e Klinës përballet me mungesë të specialistëve të mjekësisë familjare, buxhet të vogël për shëndetësi, mungesë të barnave, materialit hargjues sanitar, prishjet e shpeshta të autoambulancave, etj.

Komuna e Klinës, ashtu sikurse edhe komuna e Malishevës, është e prekur nga ethet hemorragjike gjatë sezonës së verës, mirëpo kjo sëmundje nuk është edhe aq e përhapur sa në komunën e Malishevës.

³⁰ Për mungesën e kompensimit për kujdestarinë e natës është ankuar edhe anëtarja e Kuvendit Komunal Qamile Çitaku në seancën e dytë të KK për 2011 (25 shkurt 2011);

9. Transparenca

Transparenca në komunën e Klinës nuk mund të klasifikohet si e kënaqshme. Përkundër asaj se zyrtarja për informim në komunën e Klinës i përgjigjet rregullisht kërkesave për qasje në dokumente publike, mungon qasja proaktive e zyrtarëve të kësaj komune për të postuar sa më shumë informata dhe dokumente në ueb faqen zyrtare të komunës. Komuna e Klinës nuk ka pranuar të bëjë publike të dhënat e detajuara për shpenzimet e buxhetit të komunës së Klinës për 2011 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.³¹ Po ashtu kjo komunë nuk i është përgjigjur pozitivisht kërkesave për të bërë publike “mendimin e ekspertëve të cilët kanë konstatuar se në qendër të qytetit të Klinës mund të ndërtohet edhe mbi gjashtë katëshe, edhe pse Plani Zhvillimor Urban e thotë të kundërtën”, si dhe vendimin e Komunës për të lejuar ndërtimin e dy kateve shtesë në dy objektet e koncesionuara.

Në uebfaqen e komunës së Klinës nuk gjenden njoftimet e kontratave për prokurim publik. Nga 227 kontrata të lidhura të prokurimit publik gjatë viteve 2010-2011, vetëm 6 njoftime (apo 2.6%) janë të publikuara në ueb faqe të komunës. Nuk është i publikuar asnjë raport i punës së Kryetarit të Komunës; është i publikuar vetëm një raport vjetor i punës së drejtorive; nuk janë të publikuara raportet e auditorit të brendshëm, etj. Tabela më poshtë pasqyron përmbajtjen e ueb faqes së komunës së Klinës. Nga kjo tabelë mund të shihet se përkundër asaj se Komuna e Klinës posedon një ueb faqe zyrtare, për të cilën shpenzohen mjete buxhetore për mirëmbajtjen e saj dhe ka të angazhuar zyrtar për informim publik, ueb faqja e kësaj komune nuk përmban raportet dhe dokumentet me rëndësi për komunën.

Tabela nr.12: vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Klinës

<http://kk.rks-gov.net/kline/home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së	x	x	x	x	x	x	x	√	x

³¹ Instituti GAP ka dërguar kërkesë më 19 korrik 2012 për qasje në të dhënat analitike të kontos së komunës së Klinës për të pasur qasje në shpenzimet e detajuara për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve më 2011. Komuna e Klinës është përgjigjur më 20 korrik, por duke dërguar raportin e rregullt financiar dhe jo atë të detajuar.

Shëndetësisë dhe Mir.Sociale									
Raportet e Drejtorisë së Inspekcionit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Shërbimet Publike dhe Emergjente	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	√	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	Përkundër asaj se përgjatë viteve 2010-2011 Komuna e Klinës ka dhënë 227 kontrata, në uebfaqen e kësaj komune janë publikuar vetëm 6 njoftime të kontratave apo vetëm 2.6% të njoftimeve.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x			√				√	
Rregulloret Komunale									
Vendimet e Kuvendit Komunal	x				Komuna e Klinës ka vetëm një vendim të KK të publikuar.				x
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	Është e publikuar vetëm Korniza Afatmesme Buxhetore 2013-2015.								

X = mungon raporti

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Sokol Bashota, para elektoratit të tij ka prezantuar një mori premtimesh. Pas numërimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në vitin 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës duke ia përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna, dhe njëkohësisht duke kërkuar realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë pasqyron progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 17 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP, del se pas afro tri viteve të qeverisjes në komunën së Klinës, disa projekte janë realizuar me sukses, por shumica e projekteve janë në proces të realizimit apo nuk kanë filluar ende.

Premtimet	Realizimi
Investime në vlerë 50 milion euro.	Dhënia e këtij premtimi nuk është përcjellë me sqarime se a bëhet fjalë për investime të formës publike apo nga partneriteti publiko privat. Është vështirë të matet ky premtim. Por nëse matja e premtimit bëhet në bazë të investimeve të bëra në formën publike, atëherë për më shumë se dy vite të qeverisjes në mandatin e dytë të kryetarit janë investuar më pak se 8 milionë euro në investime kapitale, shifër kjo ku bëjnë pjesë edhe investimet e bëra nga niveli qendror i institucioneve, veçmas nga Ministria e Infrastrukturës dhe MASHT-së.
Investime në infrastrukturën rrugore, shkolla, shëndetësi dhe rini.	Komuna ka investuar në infrastrukturën rrugore dhe shkolla (në bashkëpunim edhe me ministritë), siç është ndërtimi i objektit të shkollës së mesme dhe shtrimi i shumë rrugëve në qytet dhe fshatra. Mirëpo kanë ngecur investimet në shëndetësi dhe rini. Drejtoria e Shëndetësisë është një nga drejtoritë me buxhetin më të vogël në 2012, si dhe përballet me probleme të shumta. Kurse sa i përket rinisë, nuk ekzistojnë projekte domethënëse në mbështetjen e rinisë, mungon Palestra e Sporteve. Më 22 mars 2012 OJQ "Koha" kishte dërguar një reagim në drejtim të Komunës në të cilin shpreheshin këto shqetësime: mungesa e hapësirave për ushtrim të aktiviteteve; mungesa e Shtëpisë

	së Kulturës; mungesa e sallës së mirëfilltë për lexim; mungesa e hapësirave për sporte dhe aktivitete rekreative; shuarja e klubeve sportive; mos kontrolli i duhur i lokalëve nga ana e inspektoratit komunal për ato lokale që shesin alkool edhe personave të mitur; etj.
Strehimin e familjeve të dëshmorëve, luftëtarëve, nevojtarëve dhe të gjithë atyre që janë në gjendje të rëndë sociale.	Komuna ka ndërtuar një objekt të banimit social në të cilin janë vendosur 23 familje me gjendjen më të rëndë sociale. Në procesin e përzgjedhjes së familjeve për tu vendosur kanë marrë pjesë edhe anëtarët e opozitës dhe sipas tyre i tërë procesi ka shkuar në mënyrë të drejtë.
Ngritjen e një objekti banimi enkas për familjet e dëshmorëve, invalidët, dhe veteranët e luftës.	Premtim i pa realizuar.
Pajisjen e QMF-së me internet dhe sigurimin e të dhënave në mënyrë elektronike të cilat do të përdoren për histori për çdo pacient.	Kjo nuk është realizuar.
Ndërtimin e Shtëpisë së Re të Kulturës në vendin ku ndodhet e vjetra, e cila do t'i ketë 420 ulëse, dhoma përcjellëse, dhe bibliotekë me 50 ulëse (brenda vitit 2010).	Shtëpia e Kulturës nuk është ndërtuar brenda vitit 2010, ashtu siç ishte premtuar nga Kryetari, e as brenda vitit 2011. Shtëpia e Kulturës vështirë të përfundohet edhe brenda vitit 2012, për shkak të zvarritjes së punëve.
Ndërtimin e stacioni të autobusëve tek stacioni i trenit	Kjo nuk është realizuar. Klina është një ndër qytetet e pakta në Kosovë e cila nuk posedon stacion të autobusëve.
Mbështetjen e futbollit, boksit, hendbollit dhe sporteve të tjera	Përveç mbështetjes së klubit futbollistik "Dukagjini" i cili garon në nivele të ulëta të garave, sportet tjera nuk janë ekzistente. Madje edhe në klubin e futbollit "Dukagjini" ka probleme të shumta, ku ndodh shpeshherë që lojtarët të bojkotojnë stërvitjet dhe ndeshjet e këtij ekipi. Komuna e Klinës para disa viteve kishte një nga klubet më të suksesshme të volejbollit për meshkuj, mirëpo ky klub është shuar për shkak të mungesës së përkrahjes.

Rregullimin e palestrës sportive	Rregullimi i Palestrës Sportive është projekt i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS). Në këtë palestër punimet janë zvarritur. Në 2012 pritet të fillohet faza e dytë e punimeve.
Ndërtimin e një shkolle të mesme në vlerë rreth 2 milion euro	Ministri e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është duke ndërtuar objektin e ri të shkollës së mesme "Fehmi Agani", projekt i cili është zvarritur. Përkundër premtimeve, as në vitin shkollor 2012-2013 mësimi nuk ka filluar në objektin e ri të shkollës së mesme "Fehmi Agani".
Funksionimin e impiantit i cili do të furnizojë me ujë të pijshëm 16 fshatra verilindor të Komunës së Klinës	Impianti është ndërtuar me ndihmën financiar të Komisionit Evropian, mirëpo i ende nuk është funksional.
Vazhdimin e kanalizimit dhe rrugëve të fshatit Gremnikë	Ka probleme në funksionalizimin e këtij projekti. Kanalizimet kanë shpërthyer duke versuar tokat e bukës së Gremnikut.
Trotuarin Gremnikë-Qypevë në aksin rrugorë Klinë-Gjakovë, nëpër të cilin udhëtojnë nxënësit e Qypevës për shkollën e Gremnikut	Premtim i përmbushur.
Lidhjen e fshatrave Gllarevë, Zabërgjë, Cerovik, dhe Cabiqi në ujësjellës	Për fshatin Ceravik ka nisur ndërtimi i ujësjellësit faza e dytë, ndërsa faza e parë është kryer gjatë 2011, ngjashëm ka ngjare edhe me fshatrat tjera, ndërsa akoma nuk ka ndonjë nismë për shtrirjen e ujësjellësit në Gllarevë.
Ndërtimin e objektit modern të ambulancës dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Gllarevë	Ambulanca akoma nuk ka nisur dhe nuk ka pasur asnjë plan komunal në këtë drejtim, ndërkaq rrugët kryesore në fshatin Gllarevë janë shtruar, por jo edhe ato dytësore apo anësore. Rrugët brenda fshatit Gllarevë asnjë nuk janë të asfaltuara edhe pse është premtuar.
Trefishimin e projekteve për lokalitetin e Jellocit	Në këtë lokalitet është asfaltuar rruga.
Ndërtimin e rrugës transitore afër fshatrave Dollc e Dresnik	Premtim i pa realizuar

11. Burimet:

1. Komuna e Klinë. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2011.
2. Komuna e Klinës. Raporti i punës i ekzekutivit të Komunës së Klinës për vitin 2011. Mars 2012.
3. Ministria e Financave. Raporti Nëntëmujor i Buxhetit 2010.
4. Ministria e Financave. Raporti Nëntëmujor i Buxhetit 2011.
5. Ministria e Financave. Raporti Nëntëmujor i Buxhetit 2012.
6. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Republikës së Kosovës për 2012.
7. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendimi nr.129/11 (http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Aktgjykim%20KI129_11_SHQ.pdf) dhe Njoftim për media (<http://www.gjk-ks.org/?cid=1,28,317>)
8. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raportet vjetore të 2010 dhe 2011.
9. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik. Vendim për aprovimin e ankesës së operatorit ekonomik “Ron-Ing” nga Deçani lidhur me aktivitetin e prokurimit publike “Punët në objektet fetare në Klinë”-LOT 1. Burimi: http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2010/vend_meremetimi_prill10.pdf
10. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf
11. Instituti GAP. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ndikimi i tyre në politikat publike. 10 tetor 2012. Burimi: <http://www.institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>
12. Instituti GAP. Letërnjoftimi i Komunës së Klinës 2009. Burimi: http://institutigap.org/repository/docs/Klina-raporti_komunal.pdf
13. Programi i IPA-s i Bashkimit Evropian për Kosovën. Studimi i Fizibilitetit për Kualitetin e ujit të pijshëm në Kosovë. 1 tetor 2009. Burimi: http://www.niph-kosova.org/index.php?option=com_jdoenloads&Itemid=6&vieë=finish&cid=39&catid=3
14. Ministria e Administratës Publike – Departamenti i Administrimit të Sherbimit Civil, qershor 2012.
15. Agjencioni Kundër Korrupsion. Formularët e Deklarimit të Pasurisë 2011. Burimi: www.akk-ks.org/2011/Komunat_e_Kosoves/Komuna_Kline/Zenun_Zeqa.pdf
16. Shqyrtimi i procesverbaleve të seancave të Kuvendit Komunal për vitet 2011 dhe 2012.
17. Intervista në terren me përfaqësues të opozitës, shoqërisë civile dhe medie.